



Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr 28/2008, neni 4 i Ligjit për Zonë Ekonomike me Nr.04/L-159, neni 3 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.01/2014 për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës së marrjes së pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik si dhe përmbajtja e regjistrimit të zonave ekonomike dhe neni 36.1 dhe 36.2 të Statutit të Komunës së Vitisë me nr. 01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 08.12.2015 aprovon këtë:

KOSOVA			
VITINA			
Pranuar - Presidenti: A. D. D. D.			
Nr. Propozimit	Numri	Shkronja	Tërra
Org. Prop.			Vendosur
01-013/1541			
10-12-2015			

V E N D I M

PËR FILLIMIN E INICIATIVËS DHE VEPRIMEVE PËRGATITORE PËR APLIKIM NË MINISTRIN E TREGTISË DHE INDUSTRIË PËR MARRJEN E PËLQIMIT PËR THEMELIMIN E ZONËS EKONOMIKE NË ZONËN KADASTRALE BUDRIKË E EPËRME

Neni 1

Me këtë vendim fillohet iniciativa për kryerjen e veprimeve përgatitore për aplikim në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e Zonës Ekonomike, me qëllim të funksionalizimit të Zonës Ekonomike me status ekonomik "Park Industrial", me vendndodhjen në njësinë kadastrale nr. 641-1 në pronësi të Komunës së Vitisë, me sipërfaqe përafërsisht prej 15.50,00 ha, zona kadastrale Budrikë e Epërme Komuna e Vitisë.

Qëllimi i miratimit të këtij vendimi është një nder parakushtet e përcaktuara me dispozita ligjore për aplikim në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, për tu pajisur me pëlqim për themelimin e Zonës Ekonomike.

Qëllimi dhe destinimi i themelimit të kësaj Zone Ekonomike është që të behet inkurajimi i investitorëve në territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Obligimet e Drejtorive Komunale

1. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, obligohet që të marrë të gjitha veprimet që vendndodhja e Zonës Ekonomike të jetë në përputhshmëri me Planin hapësinorë rregullues urban të komunës.

2. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, po ashtu obligohet që të ndër marr të gjitha veprimet që të harmonizojnë kushtet e përgjithshme të planifikimit dhe rregullimit të hapësirës të Zonës, e cila do të jetë pjesë integrale e zonës ekonomike si tersi me planin zhvillimor komunal.

3. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe drejtorit tjera relevante, obligohet që ta përgatisin dokumentin mbi arsyshmerinë ekonomike, fiskale mjedisore dhe administrative, për themelimin e Zonës Ekonomike në pajtim me dispozitat e ligjit Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike dhe Udhëzimi administrativ (MTI) Nr.01/2014 për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtja e regjistrimit të Zonave Ekonomike.

Neni 3

Organizimi i konsultimit me publikun

Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të organizojnë konsultime me publikun në vendndodhjen e propozuar për themelimin e Zonës Ekonomike dhe të hartoj raport mbi konsultimin me publikun, i cili bashkë me dokumentacionin e nevojshëm duhet ti paraprijë procedurës së marrjes së pëlqimit dhe miratimit të Vendimit për themelimin e Zonës Ekonomike.

Neni 4

Ky vendim, hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal i Vitisë

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

